

DEKRET
Nr.178, datë 15.5.1992

PËR RUAJTJEN E AEROPORTIT TË RINASIT

Me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

DEKRETOJ:

Neni 1

Aeroporti i Rinasit, i cili administrohet nga Ministria e Transporteve dhe Komunikacioneve, shpallet objekt i rëndësisë së veçantë dhe merret në ruajtje nga forcat e Ministrisë së Mbrojtjes.

Rregullat e ruajtjes dhe të mbrojtjes së aeroportit të Rinasit përcaktohen nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 2

Kur vërehen shkelje të rregullave të ruajtjes, të mbrojtjes ose sigurimit të aeroportit nga persona të jashtëm, kur shkelja nuk formon vepër penale, komandanti i repartit ushtarak të ruajtjes së aeroportit dhe ai i policisë kufitare kanë të drejtë të gjobitin me 1000 deri 5000 lekë, dhe në rast përsëritjeje, edhe me marrjen e bagëtive ose mjeteve të tjera që kanë shërbyer për kryerjen e kundravajtjes.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, sipas rastit, te ministri i Mbrojtjes ose i Rendit Publik, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit, vendimi i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 3

Kur hyrja në aeroport e personave të jashtëm, ndodh edhe për shkak të mospërmbyshjes së rregullt të detyrës ose neglizhencës nga ana e forcave ushtarake dhe policore të ruajtjes së aeroportit, kur shkelja nuk përbën vepër penale, personat përgjegjës të këtyre forcave dënohen me masën ndëshkimore më të rëndë që parashikon Rregullorja e Disiplinës e Forcave të Armatosura.

Neni 4

Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve dhe Ministria e Mbrojtjes me fondet e tyre, si dhe me fondet e nevojshme shtesë që do t'i akordohen nga Këshilli i Ministrave të bëjnë brenda muajit korrik rrethimin e aeroportit dhe pajisjen me mjetet më të domosdoshme të sinjalizimit dhe ndriçimit.

Neni 5

Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Ruajtjes së Rendit Publik përcaktojnë detyrat dhe rregullat e veçanta për ndërmarrjet, repartet ose njësitë vartëse të tyre për hyrjen, administrimin, ruajtjen dhe sigurimin e aeroportit e të mjediseve të tij.

Neni 6

Ministria e Transporteve dhe Komunikacioneve dhe Ministria e Mbrojtjes përcaktojnë edhe mënyrën e mbulimeve të shpenzimeve financiare që bëhen për ruajtjen e aeroportit.

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.7568, datë 25.5.1992.